



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 481 Prot.

Tiranë, më 02.03.2026

VENDIM

Nr. 28, datë 02.03.2026

PËR

**MIRATIMIN E LOGOS ZYRTARE NË KUADËR TË 60-VJETORIT TË
UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në VKM nr. 145/2021 "Për dhënien e statusit të veçantë të Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e Universitetit të Arteve, i ndryshuar, si dhe në shkresën nr. 238 prot., datë 02.02.2026 të Dekanit të Fakultetit të Arteve të Bukura, me lëndë: "Relacion mbi zhvillimin e workshop-it me temë Dizajnimi i logos së 60-vjetorit të Universitetit të Arteve", pas diskutimeve, unanimisht,

VENDOSI:

1. Të miratohet si logo zyrtare e 60-vjetorit të Universitetit të Arteve, logoja fituese e konkursit studentor të organizuar për këtë qëllim, e studentes Mikea Dusha, sipas materialit grafik bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Logoja e miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi të përdoret në të gjitha dokumentet zyrtare të qarkullimit të brendshëm të Universitetit të Arteve, si dhe në materialet promocionale, përgjatë vitit kalendarik 2026.
3. Ndalohet përdorimi i logos në rastet e mëposhtme:
 - a) Deformimi i formës origjinale të logos;
 - b) Ndryshimi i ngjyrave të përcaktuara në skedën zyrtare të logos;
 - c) Shtrembërimi i proporcionit dhe raporteve grafike të logos;
 - d) Përdorimi i logos mbi sfond me kontrast të pamjaftueshëm që cënon lexueshmërinë e saj;
 - e) Aplikimi i efekteve grafike si hije, gradient, kontur apo elemente të tjera vizuale që ndryshojnë paraqitjen origjinale të logos.
4. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit ngarkohet të hartojë një dokument standard në format Word, ku përfshihet logo e 60-vjetorit, si dhe të sigurojë shpërndarjen e tij tek autoritetet drejtuese, stafi ndihmësakademik si dhe stafi administrativ i Universitetit të Arteve.

5. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI



Prof. Arben LLOZI

Prof. Najada HAMZA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Kristina LAÇO

Prof. Asoc. Genci FUGA

Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion SHIMA

Enea TRIMI (Student FAB)

Rei KITA (Student FM)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Feh. Artur të Basha Nr. Prot -, Data 2.2.2026

Shkurtimi i lëndës Relacioni midis 'Shprehjes' e Workshop

Për trajtim nga: (struktura të tjera të ngarkuara)	<u>Per Jem'at'ia</u>
Me porosi:	<u>Per ISA</u>

Afati: ☐ Normal (7 ditë) ☐ Prioritet (3 ditë) ☐ Urgjent (brenda ditës) ☐ Pa afat /Për dijeni ☐ Tjetër _____ ditë

Data 02/02/2026 Nr. Prot 238
(TITULLARI) _____

Nënshkrimi: _____

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim Specialistit: _____

Me porosinë: _____

Trajtimi materialit përfunduar më: _____

Specialisti

Trajtimi i materialit pranuar më: _____

Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar më: _____

Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar më: _____

Eprori në shkallë hierarkike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA
DEKANI

Nr. 238 Prot

Tiranë, më 01/02/2026

Lënda: *Relacion mbi zhvillimin e workshop-it me temë "Dizenjimi i logos së 60-vjetorit të Universitetit të Arteve"*

REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE
Prof.Asc. Dr. Erald BAKALLI



I nderuar zoti Rektor!

Në vijim të Urdhrit Nr. 153, datë 18.12.2025, "Për shpalljen e konkursit për përzgjedhjen e logos fituese në kuadër të 60-vjetorit të Universitetit të Arteve", ju informojmë se Fakulteti i Arteve të Bukura, përmes Programit të Studimit Pikturë, Grafikë, zhvilloi një punëtori (workshop) intensive tre-ditore me temën: "Dizenjimi i logos së 60-vjetorit të Universitetit të Arteve".

Punëtorja u realizua pas shpalljes së konkursit dhe u zhvillua si proces pedagogjik dhe krijues, me përfshirjen aktive të studentëve, nën mentorimin e pedagogëve Harri Aleksi dhe Kein Katroshi.

Gjatë tre ditëve të punës intensive, studentët u angazhuan në një proces të strukturuar që përfshiu fillimisht marrje informacioni përmes leksioneve të dy mentorëve, e më pas u vijua me kërkim konceptual, analizë vizuale, zhvillim tipografik, skicim, si dhe ndërtim të propozimeve finale grafike. Si rezultat i këtij workshop-i u realizuan dhe u paraqitën 17 propozime zyrtare të logos së 60-vjetorit, të cilat u dorëzuan për vlerësim në kuadër të konkursit.

Në vijim të këtij procesi, ditën e enjte, datë 29 janar 2026, u mbledh Komisioni i Vlerësimit, i përbërë nga pedagogët e Programit të Studimit Pikturë – Grafikë si më poshtë:

- * Prof. Asoc. Dr. Ardian Isufi
- * Lektor Petraq Papa
- * Asistent Lektor Harri Aleksi
- * Asistent Lektor Kein Katroshi


me pjesëmarrjen dhe dakordësinë e Dekanatit të Fakultetit të Arteve të Bukura, përfaqësuar nga Dekani Prof. Sadik Spahija.

Pas shqyrtimit të të gjitha propozimeve të paraqitura, komisioni, mbi bazën e kriterëve funksionale, grafike dhe institucionale të përcaktuara në udhëzimet e konkursit, vendosi me konsensus shpalljen si logo fituese të propozimit të realizuar nga studentja:

Mikea Dusha

Logoja u vlerësua si zgjidhja më e përshtatshme për përfaqësimin zyrtar të 60-vjetorit të Universitetit të Arteve, për shkak të qartësisë së lexueshmërisë së numrit “60”, ndërtimit tipografik të qëndrueshëm, funksionimit korrekt në të gjitha përmasat dhe format e riprodhimit, si dhe përshtatshmërisë së saj për përdorim institucional në dokumentacion zyrtar, materiale promovuese dhe komunikim publik gjatë vitit kalendarik 2026. Propozimi ruan neutralitetin dhe seriozitetin e nevojshëm për një identitet universitar dhe bashkëjeton në mënyrë harmonike me logon ekzistuese të Universitetit të Arteve, pa e konkurruar apo mbivendosur atë.

Në përfundim, Komisioni i Vlerësimit dhe Dekanati i Fakultetit të Arteve të Bukura propozojnë zyrtarisht këtë logo si logo përfaqësuese të 60-vjetorit të Universitetit të Arteve, në përputhje me qëllimin dhe kriteret e konkursit.

 **PROF. SADIK SPAHIJA**

DEKAN

FAKULTETI ARTEVE TË BUKURA



SKEDË UDHËZUESE TEKNIKE


PËR LOGON JUBILARE "60 VJET"

UNIVERSITETI I ARTEVE

Kjo skedë udhëzuese përcakton rregullat bazë për përdorimin grafik të logos jubilarë "60 Vjet Universiteti i Arteve" dhe është pjesë përbërëse e dokumentacionit zyrtar të institucionit. Çdo përdorim jashtë këtyre udhëzimeve kërkon miratim paraprak nga Universiteti i Arteve.




Logo "60"



Bashkëshoqërimi i logos "60" me logon "UART"



Përdorimi i miratuar i logos "60"



Paleta Zyrtare e Ngjyrave



Përdorimi në sfond me ngjyrë të errët



Përdorimi bardhë e zi / Grayscale

Ndalohet përdorimi i logos në rastet e mëposhtme:

- deformimi i formës origjinale të logos;
- ndryshimi i ngjyrave zyrtare të përcaktuara në këtë skedë;
- shtrembërimi i proporcionit dhe raporteve grafike;
- përdorimi i logos mbi sfond me kontrast të pamjaftueshëm që cenon lexueshmërinë;
- shtimi i efekteve grafike si hije, gradient, kontur (outline) apo elemente të tjera vizuale.







